



Proçesverbal i Takimit të 12-të të Grupit të aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

25 Mars, 2016
Qendra e Informacionit, Parku Kombëtar Pelister
Republika e Maqedonisë



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 12-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 26 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Staf i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Zëvendës-Presidentit të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 12-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 25.03.2016

ANNEX 2: PPP_Prespa arritjet dhe rezultatet Tetor 2015 – Mars 2016

ANNEX 3: Grant Skema e dytë ABDA_“Prespa”_ENG

Programi i takimit:

Takimit i 12-të i Grupit të aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:00 – 10:30 **Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes**

10:30 – 10:40 **Fjalimi i mirëseardhjes**

Z. Pece Cvetanovski – Parku Kombëtar Pelister

Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:40 – 10:45 **Prezantimi i programit**

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:45 – 11:05 **Arritjet e përgjithshme të zbatimit të ABDA në Rajonin Ndërkufitar “Prespa” (periudha Tetor 2015 – Mars 2016)**

Vizibiliteti dhe mbështetja në vazhdimësi për aktivitetet “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin “Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:05 – 11:30 **Diskutim rreth Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa”**

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:30 – 11:50 **Pushim kafe**

11:50 – 12:10 **Aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Ndërkufitar “Prespa”.**

Vendosja e partneriteve në vazhdimësi rreth thirrjeve për aplikime në rajonin ndërkufitar “Prespa”



Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar "Prespa"

12:10 – 13:30 **Skema e Granteve në projektin LEIWW**

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar "Prespa"

13:30 – 13:40 **Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme**

13:40 – 14:40 **Dreka**

16:45 – 17:30 **Vizitë ne terren në Parkun Kombëtar Pelister**

15:40 – **Kthimi**

Procesverbal i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes të Menaxherit Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" Z. Damjan Surlevski, i cili falenderoi për mikëpritjen e takimit të 12-të në Parkun Kombëtar Pelister si dhe gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim të frutshëm me të gjithë aktorët në vazhdim.

Në emër të Parkut Kombëtar Pelister përshëndeti Z. Pece Cvetanovski i cili falenderoi gjithë pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitete të tilla të rëndësishme në Parkun Kombëtar më të vjetër në Republikën e Maqedonisë.

Më pas Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" edhe në emër të Presidentes së Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit duke theksuar rëndësinë e konsolidimit dhe vazhdimin e bashkëpunimit me të gjithë grupin e aktorëve në kuadër të programit ABDA.

Në vazhdim, Z.Damjan Surlevski prezantoi në detaje programin e takimit duke u ndalur në çdo sesion të programit dhe çështjeve për tu trajtuar.

Sesioni 1

Arritjet e përgjithshme të zbatimit të ABDA në Rajonin Ndërkufitar "Prespa" (Periudha Tetor 2015 – Mars 2016)

Seanca filloi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila pasi falenderoi grupin për pjesëmarrjen, pasqyroi aktivitetet e kryera dhe arritjet e përgjithshme të zbatimit ABDA për periudhën Tetor 2015 – Mars 2016.

Prezantimi u fokusua në ecurinë dhe detajet e veprimeve të ndërmarra, arritjeve të përgjithshme, organizimin e takimeve me donatorët që operojnë në rajonin ndërkufitar "Prespa", informimin për mbështetjen dhe konsulencën e grupit të palëve të interesuara në përgatitjen e projekt propozimeve si dhe detaje për organizimin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit. Në përfundim të prezantimit u vazhdua me një



diskutim të hapur me pjesëmarrësit dhe rahjen e mendimeve për aktivitete të ardhshme në rajonin e Prespës.

Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e finalizimit të databazës me projektet e zbatuara në rajonin e Prespës. Kështu, dokumenti databazë i realizuar nga organizata DMO do të shpërndahet për komente të mëtejshme me të gjithë antarët, aktorët palë të grupit Prespa. Gjithashtu, u konkludua se Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të bashkëpunojë me grupin e aktorëve të palëve të interesuar për krijimin dhe plotësimin e databazës të projekteve të zbatuara në rajon.

Në këtë kuadër, Njësia për Menaxhimin e Projektit do të rishikojë formatin portofol dhe do ta ndajë atë me grupin e aktorëve të palëve të interesuar, me qëllim mbledhjen e informacionit për plotësimin e databazës të projekteve të zbatuara (projekte gjithëpërfshirëse) në rajonin Prespa.

Gjithashtu, gjatë diskutimit për organizmin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit u sugjerua që për eventet specifike – “Forumi i Biznesit Prespa” dhe “Seminari rajonal për promovimin e rajonit ndërkufitar Prespa si një destinacion Turistik”, aktorë potencialë si Organizata e Marketingut Prespa duhet të sugjerohet të marrin pjesë si edhe konkluzionet e aktiviteteve të ndahen me të gjithë grupin e aktorëve të palëve të interesuara.

Në vazhdim, antarë të grupit sugjeruan që ide dhe projekt ide të tjera mund të zhvillohen si aktivitete potenciale që mund të mbështeten në programin Njerëzit për Njerëzit.

Në lidhje me aktivitetet e ardhshme, gjatë diskutimit u konkludua se Njësia për Menaxhimin e Projektit dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informuese ku antarë të grupit të palëve të interesuara do të marrin informacionin e nevojshëm për programe dhe thirrje për aplikime të reja. Faqja zyrtare e internetit (web) aktive dhe faqja e Facebook për rajonin ndërkufitar Prespa do të pasurohet me informacion relevant me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të mbështesë përgatitjen e aplikimeve për thirrje të ndryshme si edhe do të lehtësojë partneritete të mundshme për thirrje aktive të programeve IPA CBC në rajon dhe thirrjeve të tjera aktive. Gjithashtu, Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë

Sesioni 2

Diskutim rreth Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa”

Gjatë këtij sesioni Z. Damjan Surlevski u kërkoi pjesëmarrësve një shqyrtim më të hollësishëm të Protokollit Operacional dhe rregullave të procedurës të Palëve të Interesuara me komente dhe sugjerimet konkrete. Kështu, duke parë rëndësinë e këtij dokumenti ai prezantoi sugjerimet konkrete të antarëve të grupit të palëve të interesuara si edhe hapi diskutimin për rishikimin e disa neneve në dokument. Në lidhje me Nenin 3 (tre) për emërimin dhe strukturën e grupit të interesit diskutimi u fokusua rreth përgjegjësisë së kryetarit. Kështu, u sugjerua nga grupi i antarëve që



në këtë fazë asnjë prej tyre nuk mundet ta marrë këtë përgjegjësi dhe se Njësia për Menaxhimin e Projektit duhet të vazhdojë të organizojë mbledhjet e grupit të palëve të interesuara. Në vazhdim diskutimi u fokusua kryesisht tek nenit 10 (dhjetë) dhe 12 (dymbëdhjetë). Kështu, në lidhje me pikën 2 të nenit 10: “Anëtarët e SHG do të trajtojnë punën e trupit si konfidenciale”, u sugjerua që kjo këtë fjali ose duhet të hiqet fare ose të ndryshohet me qëllim që ti japë mandatin antarëve të caktuar për të ndarë informacion relevant pas miratimit nga grupi i antarëve të interesuara. Në lidhje me nenin 12 u ra dakort që pjesa e deklaratës së paanshmërisë dhe kodit të sjelljes duhet të hiqet nga dokumenti dhe ti shtohet formatit të nominimit zyrtar. Kështu, formati i nominimit zyrtar do të rishikohet dhe do ti shtohet pjesa e deklaratës së paanshmërisë dhe kodit të sjelljes. Sugjerimet finale do të bashkangjiten në dokumentin e Protokollit Operacional për grupin e aktorëve “Prespa” dhe Rregullores së punës dhe do të diskutohet për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Sesioni 3

Skema e Granteve në projektin LEIWW

Sesioni filloi me prezantimin e Z. Damjan Surlevski Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”. Prezantimi u fokusua në pasqyrimin e Skemës së dytë të Grantit ABDA për zhvillimin e integruar ekonomik. Përveç kësaj u dhanë informacione të detajuara në lidhje me objektivat kryesore të Thirrjes për Grant, aplikantët e mundshëm, afati kohor, dorëzimin e aplikimeve dhe procesit të implementimit, zonat përfituese, draft kriteret, sektorët e mundshëm ekonomike për mbështetje, investimet e përshtatshme, kostot e pranueshme / jo të pranueshme, afati i pagesave dhe korniza financiare e Thirrjes. Shpjegime të mëtejshme u dhanë për secilën çështje duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të integruar ekonomik përmes lehtësimit të rregullimit dhe bashkëpunimit midis popullsisë lokale, sipërmarrësve, sektorin e vogël bujqësor, ofruesit e shërbimeve lokale të turizmit dhe aktorëve të tjerë të komunitetit rural në rajonet ndërkufitare për organizimin e proceseve të përbashkëta të punës dhe ndarjen e burimeve. Sesioni vazhdoi me diskutim të hapur për komente dhe sugjerime.

Antarët e grupit të aktorëve theksuan se Skema e Grantit ABDA në projektin LEIWW do të krijojë një mundësi shumë të mirë për rajonin e Prespës për të treguar kapacitetet potenciale të rajonit dhe gjithashtu të kontribuojë në përmirësimin e zhvillimit të integruar ekonomik në rajon. Gjatë diskutimit aktiv u sugjerua se në lidhje me aplikantët e mundshëm në sektorin publik, ndërrmarjet publike që operojnë brenda Bashkive duhet të shtohen si aplikantë potencialë për skemën e granteve. Në përfundim të diskutimeve u ra dakort që Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të mbledhë dhe zhvillojë veprime dhe ide që mund të mbështeten përmes skemës së granteve ose programit Njerëzit për Njerëzit dhe gjithashtu antarët e



grupit të aktorëve do të informohen dhe ftohen në Ditët Informuese për Skemën e Granteve.

Sesioni 4

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacion e nevojshëm për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon;
- Faqja zyrtare aktive e internetit dhe faqja zyrtare në Facebook për rajonin ndërkufitar Prespa do të përmirësohet me informacion relevant me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Gjithashtu, antarë të grupit duhet të dërgojnë informacion relevant pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit me qëllim ndarjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për veprime dhe aktivitete të zbatuara në rajon;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” do të bashkëpunojë me antarë të grupit të palëve të interesuara për krijimin e një databaze lidhur me projektet e realizuara në rajon. Gjithashtu, ajo do të ndajë databazën e finalizuar nga organizata DMO me të gjithë antarët e grupit për sugjerime dhe komente shtesë;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” do të do të ndajë dhe rishikojë formatin prtofolio me antarët e grupit të palëve të interesuara me qëllim mbledhjen dhe përmirësimin e informacionit për databazën e projekteve të zbatuara (projekte gjithëpërfshirëse në fusha të ndryshme) në rajonin e Prespës;
- Protokollit Operacional dhe Rregullorja e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa” do të rishikohet sërish me komentet e sugjeruara nga antarë të grupit në lidhje me nenin 3 (tre) dhe 12 (dymbëdhjetë). Dokumenti përfundimtar do të ndahet me grupin e antarëve dhe do të miratohet në takimin e ardhshëm;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” në bashkëpunim me anëtarët e grupit të aktorëve do të synojnë në mbledhjen, zhvillimin e veprime dhe ideve të tjera të cilat mund të mbështeten nga skema e granteve ose nga programi “Njerëzit për Njerëzit”;



- Skema e Grantit ABDA në projektin LEIWW do të krijojë një mundësi shumë të mirë për rajonin e Prespës për të treguar kapacitetet potenciale të rajonit dhe gjithashtu të kontribuojë në përmirësimin e zhvillimit të integruar ekonomik në rajon;
- U sugjerua se në lidhje me aplikantët e mundshëm në sektorin publik, ndërrmarjet publike që operojnë brenda Bashkive duhet të shtohen si aplikantë potencialë për skemën e granteve.
- Antarët e grupit të aktorëve do të informohen dhe ftohen në Ditët Informuese për Skemën e Granteve.

Përgatiti:

Etleva Thimo

Koordinatorë Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës

